# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7032
E premte, 27 tetor 2023
Çmimi 0. 50 €


## Mjeranët dhe llaskuçët e pushtetit!

FAQE 9



Behxhet Sh. SHALA


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


MINISTRIA E MBROJTJES DHE FSK-ja MBAJTËN EDICIONIN E 15-TË TË KONFERENCËS VJETORE NDËRKOMBËTARE "FSK DHE PARTNERËT 2023"

# PARTNERËT NDËRKOMBËTARË PËRKRAHIN PLANIN E TRANZICIONIT TË FSK-SË PËR T'U BËRË NJË FORCË MBROJTËSE TERRITORIALE



Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) të enjten kanë organizuar konferencën vjetore ndërkombëtare "FSK dhe partnerët 2023". Partnerët ndërkombëtarë gjatë kësaj konference shprehën mbështetje për FSK-në, veçanërisht për planin dhjetëvjeçar të tranzicionit të saj për t'u bërë një forcë mbrojtëse territoriale profesionale. Ata njëzëri dënuan sulmin terrorist në Banjskë të Zveçanit

## KURTI DHE VUÇIQI TAKOJNË UDHËHEQËSIT EVROPIANË, U KËRKOHET ZBATIMI I MARRËVESHJEVE TË ARRITURA

FAQE 3



## PUSHTETI E EMËROI, PUSHTETI E SHKARKOI BORDIN E KPMM-së

FAQE 7



## OPINION

### SISTEMI I KONTROLLIT TË NDIHMËS SHTETËRORE NË KOSOVË: ROLI I INSTITUCIONEVE PËRKATËSE

F. 7

Shkruan: Elton TOTA



## AKTUALE



### KUSH ËSHTË MIKE JOHNSONI, KRYETARI I RI REPUBLIKAN I DHOMËS SË PËRFAQËSUESVE?

F. 2

### RUSIA I KËRKON GJYKATËS SPECIALE NË HAGË TA DËNOJË HASHIM THAÇIN

F. 5

## EKONOMI



### REMITENCAT DERI NË MUAJIN SHTATOR TEJKALOJNË VLERËN E 1 MILIARD EUROVE

F. 8

### DËSHTON REZOLUTA E AAK-së PËR NGRITJEN E KOEFICIENTIT TË PAGAVE, LV-ja E LËSHON SEANCËN

F. 8

## SPORT

### KOSOVA ME RENDITJE HISTORIKE NË FIFA, NGJITET PËR PESË POZITA

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Mali i Zi refuzon ta ekstradojë një të dyshuar për krime lufte në Kosovë

**Podgoricë, 26 tetor** - Ministri i Drejtësisë i Malit të Zi, Marko Kovaç, ka refuzuar ta ekstradojë në Kosovë shtetasin serb Momçillo Vukotiq, 61 vjeç, i dyshuar për krime lufte në territorin e Pejës në vitin 1999, konfirmoi ministria malazeze për "Radion Evropa e Lirë". Sipas saj, kushtet ligjore për ekstradim janë plotësuar, por ministri Kovaç e refuzoi ekstradimin e tij, pasi mendon se është shkelur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. "Në vendimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës për fillimin e hetimeve nuk thuhet se cilat veprime i ka bërë Vukotiqi, të cilat janë pjesë e veprave penale, por thuhet se pas 24 vjetësh gjoja është paraqitur një dëshmitar i cili e ka njohur atë nga fotografia e tij në një album", ka njoftuar ministria malazeze.
Vukotiqi u arrestua më 25 shtator dhe ndaj tij u caktua masa e paraburgimit ekstradues.
Ai kërkohej nga Interpoli përmes UNMIK-ut, Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, nën dyshimin për krime lufte kundër popullatës civile. Kosova nuk ka lidhje me Interpolin, por komunikon me të përmes UNMIK-ut.



# Disa të vrarë nga të shtënat me armë në ShBA, i dyshuari në arrati

**Mein, 26 tetor** - Një burrë hapi zjarr të mërkurën mbrëma në një kafene dhe në një sallë boulingu në Luiston, Mein, të Shteteve të Bashkuara, duke i vrarë 22 njerëz dhe duke i lënduar dhjetëra të tjerë, raporton agjencia "Associated Press". Policia është duke e kërkuar të dyshuarin dhe i ka urdhëruar banorët të strehohen.
I dyshuari është identifikuar nga policia si Robert Card, i cili ishte trajnuar si instruktor i armëve të zjarrit në qendrën stërvitore të Rezervës Ushtarake të ShBA-së në Mein.
Sipas një dokumenti, të rishikuar nga "Associated Press", i cili u ishte dërguar oficerëve të sundimit të ligjit, Cardi ishte shtrirë në një qendër të shëndetit mendor për dy javë në verën e vitit 2023.



Dokumenti nuk ka ofruar të dhëna specifike për tretmanin apo gjendjen e tij.
Në dokument, po ashtu, thuhej se Card kishte raportuar se po dëgjonte zëra dhe se kishte kërcënuar se do të shtinte me armë zjarri në bazën stërvitore ushtarake në Sako, Mein.
Zyra e sherifit i publikoi dy fotografi të të dyshuarit në faqen e vet në "Facebook", ku shihej një sulmues duke u futur në një ndërtesë teksa e mbante lart pushkën. Autoritetet thanë se të shtënat nisën pak para orës 19:00 të mërkurën.
Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, bisedoi në telefon me guvernatoren e Mein, Janet Mills, si dhe me anëtarët e Senatit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve, duke iu ofruar atyre "mbështetje të plotë federale pas këtij sulmi të tmerrshëm", njoftoi Shtëpia e Bardhë.
Senatori nga Mein, Angus King, tha se është "thellësisht i trishtuar për qytetin Luiston dhe për të gjithë të brengosurit për familjet, miqtë dhe fqinjët e tyre", dhe se po e vëzhgon gjendjen.
Shkollat lokale do të mbyllën të enjten dhe njerëzit duhet të kërkojnë strehim në vende të sigurta, tha kryeinspektori Jake Langlais, duke shtuar: "Rrini afër më të dashurve tuaj. Përqafoni ata".
Në Mein nuk kërkohet leje për armëmbajtje dhe ky shtet e ka një kulturë të moçme të armëmbajtjes që ndërlidhet me traditat e tij për gjueti dhe për qitje sportive.
Dy zyrtarë të sundimit të ligjit thanë për "Associated Press" se së paku 16 persona u vranë dhe se ky numër pritet të rritet. Ata thanë se edhe dhjetëra njerëz të tjerë janë plagosur. Zyrtarët nuk ishin të autorizuar për të folur publikisht për hollësitë e hetimit që po vazhdon, dhe folën për AP-në në kushte anonimiteti.

# Kush është Mike Johnson, kryetari i ri republikan i Dhomës së Përfaqësuesve?



**Uashington, 26 tetor** - Përfaqësuesi amerikan Mike Johnson është zgjedhur nga kolegët e tij republikanë për të shërbyer si kryetar i Dhomës së Përfaqësuesve, pas tri javësh me trazira dhe tre kandidatëve të dështuar. Këtu janë pesë fakte rreth ligjvënësit konservator të mandatit të katërt, i cili tani është republikani kryesor në Kongres.
Johnson, 51 vjeç, lindi në Shreveport, qyteti i tretë më i madh i Luizianës. Është më i madhi nga katër vëllezërit e motrat dhe djali i një zjarrfikësi që u dogj keq dhe u paaftëzua gjatë detyrës.
Para Kongresit, Johnsoni ishte një avokat që kryesisht punonte në çështjet e lirisë fetare, duke mbrojtur me sukses ndalimin e martesës ndërmjet personave të së njëjtës gjini në Luiziana më 2004. "Unë jam një i krishterë, bashkëshort, një baba, një konservator i përjetshëm, avokat i ligjit kushtetues dhe një pronar biznesi i vogël', i tha ai gazetës "Luiziana Baptist Message" më 2016.
Ai u zgjodh në administratën shtetërore të Luizianës në vitin 2015 dhe kandidoi me sukses për Kongresin në vitin 2016. Ai tani përfaqëson distriktin e katërt të Kongresit të Luizianës, i cili zë cepin veriperëndimor të shtetit dhe përfshin qytetin e tij të lindjes Shreveport.
Johnsoni është një mbështetës i hapur i Trumpit, siç dëshmohet nga mbështetja e tij për përpjekjet e Trumpit për t'i përmbysur zgjedhjet e vitit 2020. Trumpi mbështeti zgjedhjen e Johnsonit kandidat.

## Pilotët ukrainas i nisin stërvitjet në ShBA

**Kiev, 26 tetor** - Pilotët ukrainas i kanë nisur stërvitjet me avionët e avancuar luftarakë F-16 në Shtetet e Bashkuara, njoftoi Forca Ajrore e ShBA-së të mërkurën.
Një "numër i vogël" i ukrainasve kanë filluar stërvitjet, të cilat "pritet të zgjasin disa muaj", tha një zëdhënës i Forcës Ajrore.
Muajin e kaluar u raportua se pilotët ukrainas kishin filluar të mbanin kurs të gjuhës angleze në shtetin e Teksasit.
Pilotët pritet t'i përdorin avionët luftarakë F-16 në luftime në vitin 2024.
Edhe disa vende të tjera evropiane janë duke i trajnuar pilotët ukrainas për drejtimin e këtyre avionëve. Norvegjia, Danimarka dhe Holanda i kanë dhuruar Ukrainës avionë luftarakë F-16 tashmë.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kurti dhe Vuçiqi takojnë udhëheqësit evropianë, u kërkohet zbatimi i marrëveshjeve të arritura

Kancelari gjerman Olaf Scholz, presidenti francez Emmanuel Macron dhe kryeministrja italiane Giorgia Meloni kanë kërkuar të enjten nga kryeministri Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq të ndërmarrin hapa përpara në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve të hartuara së bashku në vitet e kaluara dhe tash në muajt e fundit. Kurti dhe Vuçiqi janë pritur veç e veç nga udhëheqësit evropianë



**Bruksel, 26 tetor** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar të enjten me udhëheqësit evropianë në margjina të një samiti të BE-së në Bruksel. Kurti dhe Vuçiqi janë pritur veç e veç nga kancelari gjerman Olaf Scholz, presidenti francez Emmanuel Macron dhe kryeministrja italiane Giorgia Meloni.

Në takime ishte i pranishëm edhe shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, si dhe presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel. As Kurti as Vuçiqi nuk dhanë ndonjë deklaratë para gazetarëve.

Kryeministrja e Italisë, Giorgia Meloni, ka folur për medie lidhur me takimin që kanë pasur me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Meloni ka thënë se Italia, Franca dhe Gjermania po përpiqen të bëjnë hapa përpara sa i përket dialogut dhe se të enjten u kanë kërkuar edhe Kurtit dhe Vuçiqit të ndërmarrin hapa lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të arritura gjatë viteve të kaluara e gjatë muajve të kaluar.

Kryeministrja italiane ka thënë se pret të shohë se si do të shkojnë gjërat sot gjatë ditës duke thënë se shpreson që do të bëhen disa hapa përpara. "Pak më parë ne ishim të angazhuar në një tjetër, le të themi, skenar tjetër kritik mes Serbisë dhe Kosovës. Po përpiqemi të gjejmë një zgjidhje në bazë të qartë të punës Itali, Francë, Gjermani nga Bashkimi Evropian. Po përpiqemi të bëjmë hapa përpara dhe u kemi kërkuar të dy liderëve të ndërmarrin hapa përpara në lidhje me zbatimin e dokumenteve dhe marrëveshjeve të hartuara së bashku në vitet e kaluara dhe në muajt e kaluar. Do të shohim se si do të shkojë gjatë ditës. Shpresojmë të bëjmë disa hapa përpara", ka thënë Meloni.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka theksuar se takimet janë vazhdimësi e procesit që filloi fundjavën e kaluar, kur e ashtuquajtura "pesëshe e madhe" e të dërguarve perëndimorë vizitoi Prishtinën dhe Beogradin. "Ideja është që këto takime të zhvillohen në margjinat e samitit të BE-së, në mbështetje të kthimit në dialog. Mesazhi i BE-së është se presim që të dyja palët, Serbia dhe Kosova, t'u kthehen menjëherë dhe pa pengesa detyrimeve që dalin nga dialogu, të punohet menjëherë për uljen e tensioneve dhe rifillimin e dialogut", ka pohuar Stano.

Stano konfirmoi se plani përmban një "propozim modern evropian" për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë ndërsa, sipas burimeve të BE-së, nga Serbia kërkon ta konfirmojë mbështetjen e saj për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve.

Qeveria e Kosovës tha se Kurti është pajtuar që ky plan të jetë "korniza e vazhdimit të diskutimeve të mëtejshme me shtetet aleate".

Vuçiqi, në anën tjetër, tha se Serbia është e gatshme të bisedojë për planin, por pranoi se "takimet e planifikuara nuk do të jenë të lehta".

## Ku qëndron dialogu?

Kurti dhe Vuçiqi u takuan për herë të fundit më 14 shtator, por pa ndonjë përparim.

Dhjetë ditë më vonë ndodhi sulmi në Banjskë, ku grupe të armatosura serbësh sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë një zyrtar policor.

Gjatë përleshjeve, që nxitën shqetësime për qëndrueshmërinë në rajon, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Duke folur për gazetën britanike "Financial Times", më 25 tetor, Kurti tha se "nëse nuk do të ketë dënime dhe sanksione ndaj Serbisë pas asaj që ka bërë, definitivisht nuk do të ketë dialog".

Ky proces që synon normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë nisi në vitin 2011 me ndërmjetësimin e BE-së dhe mbështetjen e ShBA-së.

Palët arritën dhjetëra marrëveshje për këtë qëllim, por shumë prej tyre nuk u zbatuan kurrë.

Një nga to është edhe ajo për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Edhe pse ka marrëveshje nga viti 2013 për të, zyrtarët në Prishtinë thonë se e tillë siç është, do të ndikonte keq në funksionalitetin e shtetit dhe kanë dalë me disa propozime të tjera për rregullimin e çështjeve të komuniteteve pakicë.

Por, si BE-ja, ashtu edhe ShBA-ja, e rritën së voni trysninë mbi Kosovën për ta formuar Asociacionin. Derisa nga ShBA-ja thonë se ai duhet të jetë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, për BE-në çështja se si bëhet Asociacioni dhe si do të operojë, duhet të diskutohet në dialog.

# Rama: E përgëzoj Kurtin që pranoi propozimin evropian për të avancuar drejt zgjidhjes për Asociacionin

**Prishtinë, 26 tetor** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përgëzuar homologun e tij të Kosovës, Albin Kurti, për pranimin e draftit të Bashkimit Evropian për Statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kurti është pajtuar që ky draft i prezantuar në Kosovë e Serbi nga pesë diplomatë perëndimorë, të jetë bazë për diskutime rreth zbatimit të marrëveshjes bazë mes dy shteteve. E lidhur me këtë ka reaguar Rama, duke thënë se është "vërtet pikë kyçe". "Përgëzoj kryeministrin e Kosovës për pranimin e propozimit të BE-së për të përparuar me vendosmëri drejt një zgjidhjeje zhbllokuese lidhur me AKSHS, përmes instrumenteve të vetëmenaxhimit si një kuadër për negociatat vijuese. Kjo është një pikë vërtetë kyçe. Udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë duhet të tregojnë lidership dhe të punojnë ngushtësisht, pa asnjë vonesë të mëtejshme, me aleatët perëndimorë të rajonit për të zbatuar menjëherë Marrëveshjen Bazë mbi normalizimin e marrëdhënieve. Rajoni ynë meriton paqe, stabilitet dhe bashkëpunim për një të ardhme të përbashkët më të mirë, dhe jo konflikte, lojëra fajësimi dhe prapakthime që na dëmtojnë të gjithëve", ka shkruar Rama në rrjetin social "X".






MINISTRIA E MBROJTJES DHE FSK-JA MBAJTËN EDICIONIN E 15-TË TË KONFERENCËS VJETORE NDËRKOMBËTARE "FSK DHE PARTNERËT 2023"

# Partnerët ndërkombëtarë përkrahin planin e tranzicionit të FSK-së për t'u bërë një forcë mbrojtëse territoriale

Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) të enjten kanë organizuar konferencën vjetore ndërkombëtare "FSK dhe partnerët 2023". Partnerët ndërkombëtarë gjatë kësaj konference shprehën mbështetje për FSK-në, veçanërisht për planin 10-vjeçar të tranzicionit të saj për t'u bërë një forcë mbrojtëse territoriale profesionale, teksa njëzëri dënuan sulmin terrorist në Banjskë të Zveçanit

EPOKA E RE Mal QORRAJ

Prishtinë, 26 tetor - Në panelin kryesues të konferencës vjetore ndërkombëtare "FSK dhe partnerët 2023" ishin ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe drejtori i NALT-it, gjeneralbrigade Ralf Peter Hammerstein.

Pjesëmarrësit në këtë konferencë ishin edhe ambasadorë, atashe të mbrojtjes si dhe përfaqësues të tjerë diplomatikë dhe ushtarakë të të gjitha shteteve partnere të Republikës së Kosovës.

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se ishte kënaqësi për të që t'i bashkohej kësaj konference, ku ritheksoi përkushtimin e ShBA-së për ta mbështetur planin 10-vjeçar të tranzicionit të FSK-së për t'u bërë një forcë mbrojtëse territoriale profesionale, shumetnike, e ndërveprueshme nga NATO-ja, që i nënshtrohet mbikëqyrjes civile.

Hovenier edhe në këtë konferencë ka folur sërish për sulmin terrorist të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit. Ai ka thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Ministria e Mbrojtjes kanë demonstruar pjekuri profesionale atë ditë, duke ngritur reputacionin si partner i besueshëm i sigurisë dhe duke shmangur provokimet që kanë mundur të rezultojnë me përshkallëzim të mëtejshëm të situatës. "Dua ta përmend se gjatë sulmit të 24 shtatorit në sovranitetin e Kosovës nga një grup i armatosur paramilitar, Forca e Sigurisë e Kosovës dhe Ministrja e Mbrojtjes kanë demonstruar pjekurinë profesionale dhe durimin e tyre duke ngritur reputacionin si partnerë të besueshëm dhe duke shmangur provokimet që kanë mundur të rezultojnë në përshkallëzim të mëtejmë", ka thënë ambasadori amerikan.

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka theksuar se Kosova nuk do të jetë kërcënim për askënd, por do të jetë partnere e paqes. Ai ka thënë se Kosova vitet e fundit ka bërë arritje të mëdha sa i përket zhvillimit të kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes. Sipas Maqedoncit, buxheti për FSK-në është rritur për 110 për qind. "Brenda dy viteve buxheti për FSK-në është rritur për 110 për qind. Gjatë këtyre dy viteve të fundit kemi investuar në sistemin e armatimit dhe kemi marrë pjesë në ushtrime ushtarake. Për më tepër, FSK-ja ka zbarkuar në Lindjen e Mesme për operacione trajnime dhe për paqe. Ne, gjithashtu, jemi krenarë me qendrën e trajnimit që ofron trajnime të operatorëve vendorë dhe ndërkombëtarë", është shprehur ministri i Mbrojtjes.

Duke folur për sulmin terrorist në Banjskë, ministri Maqedonci tha se nuk pati sukses falë ndërhyrjes së Policisë së Kosovës. Ai ka thënë se sulmi terrorist i 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit mund të përsëritet derisa "Serbia vazhdon të këtë qasje hegjemoniste ndaj fqinjëve të saj".

Ministri tutje është shprehur se Serbia ka 48 baza operacionale përgjatë kufirit me Kosovën.

"Rëndësia jonë në operacione është dëshmuar në pjesën veriore të vendit, ku grupet serbe kanë tentuar të marrin territor dhe ta destabilizojnë vendin tonë. Duke iu falënderuar Policisë së Kosovës dhe bashkëpunimit me partnerët tanë, ky sulm flagrant nuk pati sukses. Sidoqoftë, ne jemi të vetëdijshëm se kërcënimi ende vazhdon përderisa Serbia ka 48 baza operacionale përgjatë kufirit me Kosovën dhe përderisa Serbia vazhdon të këtë qasje hegjemoniste ndaj fqinjëve të saj. Më lejoni të theksoj se Kosova nuk do të jetë kërcënim për askënd, por ne jemi të përgatitur të jemi miq të të gjithëve", ka deklaruar Maqedonci.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bashkim Jashari, ka thënë se FSK-ja nuk do të ishte këtu nëse nuk do ta kishte mbështetjen nga vendet aleate me trajnime. Ai ka theksuar se rasti i fundit në Banjskë është mesazh i qartë se FSK-ja duhet të jetë gjithmonë e gatshme për sulme të tilla. "Kërkoj nga ju

# Rusia i kërkon Gjykatës Speciale në Hagë ta dënojë Hashim Thaçin




**Prishtinë, 26 tetor** - Përfaqësuesi rus në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Vassily Nebenzia, ka kërkuar nga Gjykata Speciale t'i dënojë krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, procesi gjyqësor i të cilëve po zhvillohet në Hagë. Ai ka shprehur besimin se Gjykata Speciale "nuk do ta përsërisë gabimin e Tribunalit të Hagës dhe se ata që janë përgjegjës do ta marrin dënimin që meritojnë", duke aluduar kështu në lirimin e Ramush Haradinajt dhe Fatmir Limajt.

Këto deklarata rusi Nebezia i ka bërë gjatë seancës së KS të OKB-së, të hënën, më 23 tetor, teksa është diskutuar rreth situatës në Kosovë.

"Në këtë kontekst, është gjithashtu e qartë se Prishtina ka shpallur vazhdimësi midis 'policisë' aktuale dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një organizatë terroriste, liderët e së cilës, përfshirë Hashim Thaçin, aktualisht po gjykohen si të akuzuar për krime të rënda lufte pranë Dhomave të Specializuara në Hagë. Ne besojmë se Dhomat nuk do t'i përsëritin gabimet e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe se të gjithë ata që janë përgjegjës do ta marrin dënimin që meritojnë. Në këtë kontekst, refuzimi i Prishtinës për t'u paguar dëmshpërblim viktimave të krimeve të kryera nga luftëtarët e UÇK-së, në kundërshtim me vendimet e marra në Hagë, flet vetë në mënyrë të qartë", ka deklaruar Vassily Nebenzia.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi janë arrestuar në nëntor të vitit 2020, pas një aktakuze të ngritur nga Gjykata Speciale, ndërsa procesi gjyqësor kundër tyre ka filluar në prill të këtij viti.

Ministria e Jashtme e Rusisë asokohe pati përshëndetur arrestimet e krerëve të UÇK-së.

"Fakti që Dhoma e Prokurorit të Specializuar të Kosovës ka shtuar hetimet ndaj krimeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), me aktakuzat kundër ish-drejtuesve të këtij entiteti të neveritshëm, kanë ardhur në vëmendjen tonë. Të akuzuarit përfshijnë 'presidentin' Hashim Thaçi dhe ish-'kryetarin e Kuvendit', Kadri Veseli. Është shumë e rëndësishme të çohen para gjykatës ata që janë fajtorë për kryerjen e krimeve të rënda, të identifikuar në kohën e duhur nga raportuesi i PACE, Dick Marty, për t'i mbajtur ata përgjegjës para ligjit. Në këtë kuptim nuk duhet të ketë njerëz të paprekshëm", thuhej në deklaratën e Ministrisë së Jashtme të Rusisë.

## Ish-këshilltari i Thaçit: Fjalimi i Nebenzias, dëshmi e gjallë se Gjykata Speciale është një mjet i tyre për t'i dënuar krerët e UÇK-së

Ndaj deklaratës së përfaqësuesit rus në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Vassily Nebenzia, ka reaguar ish-këshilltari i ish-presidentit Thaçi, Artan Behrami. "Fjalimi i përfaqësuesit rus në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Vassily Nebenzia, është dëshmi e gjallë se Gjykata Speciale është një mjet i tyre për t'i dënuar krerët e UÇK-së dhe për ta ndërruar historinë. Përfaqësuesi rus madje bën presion mbi Gjykatën Speciale që t'i dënojë krerët e UÇK-së. Nejse, s'e di pse po shkoj aq larg, kur Qeveria e Kosovës ka brenda njerëz që mendojnë njëjtë si ky përfaqësuesi rus!", ka shkruar Behrami në "Facebook".




mbështetje, sepse duke u stërvitur dhe aftësuar së bashku, ne rritim gatishmërinë e vendeve tona ndaj kërcënimeve në rritje të sigurisë. Jam i sigurt që ju si përfaqësues ushtarakë jeni të informuar për rastin e sulmit terrorist të 24 shtatorit në veri të Kosovës", ka thënë Jashari, duke shtuar se FSK-ja së bashku me Ministrinë e Mbrojtjes kanë qenë në koordinim të ngushtë me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë. "Rasti i sulmit të fundit, si zhvillim i sigurisë në botë, është tregues i qartë se FSK-ja duhet të jetë çdoherë e gatshme ta kryejë misionin e saj kushtetues dhe ligjor", është shprehur komandanti i FSK-së.

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, ka pohuar se shteti i tij vazhdon të jetë partner i besueshëm i Kosovës. "Gjermania vazhdon të mbetet partnere e fuqishme dhe e besueshme e Kosovës që nga pavarësia dhe në këtë frymë ne mbështetim plotësisht procesin transformues të FSK-së", ka thënë Rohde.

Ai ka bërë me dije se Gjermania do të vazhdojë ta shtojë bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë dhe FSK-së përmes ushtrimeve të përbashkëta. "Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë FSK-në. Dua t'u bashkohem parafolësve të mi dhe të theksoj qëllimin strategjik që një ditë Kosova duhet të bëhet anëtare e familjes së NATO-s", ka potencuar ambasadori Rohde.

Kurse ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili, ka folur për mbështetjen e Turqisë në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, teksa pati edhe falënderime për ndihmën nga tërmeti në këtë shtet. Sipas tij, Turqia ka mbështetur FSK-në me 16 milionë euro. "Turqia është e interesuar të arrihet stabiliteti në gjithë vendin. Këto lidhje përcaktojnë politikat dhe lidhjet tona për ta forcuar stabilitetin në rajon dhe më gjerë. Në këtë kontekst, përkundër kësaj, dua ta falënderoj ekipin e kërkim-shpëtimit për ndihmën e dhënë gjatë tërmetit në Turqi. Për këto vite Turqia ka mbështetur FSK-në me 16 milionë euro", ka treguar ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili.

# Sistemi i kontrollit i ndihmës shtetërore në Kosovë: Roli i institucioneve përkatëse



Shkruan: Elton TOTA

### Ndihma e lejueshme

Në parim, dhënia e çdo lloj ndihme shtetërore, pavarësisht formës në të cilën jepet, konsiderohet e ndaluar për shkak të shtrembërimit ose efektit potencial në shtrembërimin e konkurrencës në treg, përderisa të mos i nënshtrohet një procesi paraprak të vlerësimit dhe vendimmarrjes nga institucionet përkatëse të ndihmës shtetërore. Duhet të jetë e qartë se ndihma shtetërore duhet t'i nënshtrohet këtij procesi vetëm kur dhënësit e ndihmës shtetërore janë institucionet shtetërore dhe ato pa dallim të nivelit apo llojit të tyre (si të tilla ato mund të jenë organe të autorizuara të administratës qendrore dhe të qeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, apo ndonjë autoritet tjetër që vepron në emër të shtetit) kurse nga ana tjetër përfitues të ndihmës shtetërore mund të jenë të gjithë ata që kryejnë veprimtari ekonomike (qoftë person fizik ose juridik, privat ose publik). Megjithatë, legjislacioni parasheh edhe përjashtime nga rregulla parimore se çdo lloj ndihme konsiderohet e ndaluar, dhe këto janë rastet si në vijim: (1) Kur ndihma konsiderohet e lejueshme/pajtueshme me ligjin; dhe për dhënien e së cilës, dhënësit e ndihmës shtetërore nuk janë të kushtëzuar me aprovimin paraprak të Komisionit të Ndihmës Shtetëror (KNSH - Komisionit), këto raste përfshijnë: (a) ndihma e karakterit social që iu jepet konsumatorëve individualë; dhe, (b) ndihma për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose ngjarjet e jashtëzakonshme. Kushti i vetëm për dhënësit e kësaj ndihme është që ndihma të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek.

(2) Kur ndihma konsiderohet në pajtueshmëri të kushtëzuar me ligjin; që do të thotë që për dhënien e kësaj ndihme, kushtet, kriteret dhe procedurat e vlerësimit të saj përcaktohen me akt nënligjor nga qeveria dhe dhënia e së cilës duhet që paraprakisht të autorizohet nga Komisioni, këtu bëjnë pjesë: (a) Ndihma shtetërore që jepet për të nxitur zhvillim ekonomik në rajonet ku standardi i jetesës është jo normalisht i ulët dhe ku ka papunësi të theksuar; (b) Ndihma shtetërore që jepet për nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm ose për mënjanimin e një çrregullimi serioz në ekonomi; (c) Ndihma shtetërore që jepet për të lehtësuar zhvillimin e disa fushave apo aktiviteteve të caktuara ekonomike, (d) Ndihma shtetërore që promovon kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë, dhe (3) Ndihma "de minimis" është ndihmë e cila nuk konsiderohet ndihmë shtetërore dhe nuk është subjekt i njoftimit dhe autorizimit të Komisionit. Gjithsesi, kriteret, fushëveprimi dhe procedurat për dhënien e ndihmave "de minimis" përcaktohen me akt nënligjor, po ashtu qeveria përcakton limitet e kësaj ndihme.

### Çfarë tjetër parasheh legjislacioni në fuqi?

Ndryshe nga më sipër, për çdo rast tjetër të ndihmës shtetërore nuk ekziston 'rasti' i pajtueshmërisë apo pajtueshmërisë së kushtëzuar me ligjin, por për dhënien e ndihmës shtetërore autoritetet përkatëse të ndihmës shtetërore për çdo rast në baza individuale kryejnë një proces të vlerësimit, dhe vendimmarrjes paraprake për dhënien e ndihmës dhe po ashtu të kontrollit dhe të monitorimit të ndihmës së dhënë. Në Kosovë, legjislacioni në fuqi e përcakton qartë kornizën institucionale të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe po ashtu edhe detyrimin e dhënësve të ndihmës shtetërore që autoriteteve përkatëse të ndihmës shtetërore t'iu ofrojnë informacione në lidhje me ndihmën shtetërore. Sistemi i kontrollit të ndihmës shtetërore përbëhet nga: (1) Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH - Komisioni) si organ i pavarur vendimmarrës, i ngarkuar me detyrat dhe përgjegjësitë kryesore që kanë të bëjnë me: (a) përcaktimin nëse një masë në shqyrtim përbën ndihmë shtetërore, (b) me marrjen e vendimeve mbi pajtueshmërinë, mos-pajtueshmërinë ose pajtueshmërinë e kushtëzuar të ndihmës shtetërore, (c) monitorimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, (d) publikimin e listës së zonave të pazhvilluara me qëllim të vendosjes së kufijve maksimal të ndihmës në lidhje me ato zona, (e) fillimin e hetimit zyrtar mbi një masë specifike të ndihmës apo (f) revokimin e ndihmës shtetërore përfshirë përcaktimin e normës së zbatueshme të interesit në këtë rast, dhe; (2) Departamenti i Ndihmës Shtetërore (DNSH - Departamenti) i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), i cili ofron mbështetje profesionale dhe administrative KNSH-së. Në këtë aspekt, detyrë e DNSH-së është që të kryejë vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore.

Në të tre këto komponentë, DNSH-ja ka një rol të rëndësishëm që mund të përmblidhet si në vijim: (a) Së pari, DNSH-ja kryen vlerësimin mbi pajtueshmërinë e ndihmës individuale dhe të skemave të ndihmës shtetërore me dispozitat ligjore si dhe përgatit raportin e vlerësimin të ndihmës përfshirë edhe propozimet për vendimmarrje për KNSH-në; (b) Së dyti, DNSH-ja kryen kontrollin ex-post të ndihmës shtetërore si dhe mund të kërkojë revokimin e ndihmës së papajtueshme, dhe; nëse ndihma shtetërore është dhënë pa një vendim paraprak të KNSH-së, Departamenti fillon procedurat për kontroll të ndihmës së paligjshme dhe për revokimin e saj, dhe; (c) Së treti, DNSH-ja ka një rol të veçantë edhe në monitorimin e ndihmës shtetërore që konsiston në mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave për ndihmën shtetërore, përfshirë ndihmën shtetërore 'de minimis' me qëllim që të kontrollojë pajtueshmërinë e ndihmës shtetërore ekzistuese me kërkesat ligjore dhe me vendimet e KNSH-së si dhe të sigurojë transparencë në fushën e ndihmës shtetërore.

*(Ky publikim është mbështetur nga projekti me titull "KSV 019 Asistenca Teknike në kuadër të Integrimit Evropian" i zbatuar nga Zyra për Kritere Ekonomike dhe Treg të Brendshëm në Zyrën e Kryeministrit dhe financuar nga Qeveria e Luksemburgut. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Qeverisë së Luksemburgut.)*

# Këshilli Iniciues paraqet propozimin e konceptit për themelimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor

**PRISHTINË, 26 TETOR** - Koncepti i Muzeut të Artit Bashkëkohor, i zhvilluar nga njohës dhe aktorë profesionistë të fushës muzeale dhe artistike, u paraqit para artistëve, kuratorëve, përfaqësuesve institucionalë dhe medieve.

MKRS-ja ka njoftuar se propozimi do të shërbejë si udhërrëfyes për krijimin dhe funksionalizimin e institucionit, gjithnjë në pajtim me dispozitat e Ligjit të ri për Art dhe Kulturë. Aty, ndër të tjera, përfshihen propozimet për konceptin e përgjithshëm të muzeut, organizimi strukturor dhe funksional, statuti i institucionit, koleksionet përkatëse, propozimet hapësinore, arkitektonike dhe ndërtimore.

Të kryesuar nga Yll Rugova, këshilli i përbërë nga Flaka Haliti, Sislej Xhafa, Petrit Halilaj, Zake Prelvukaj, Erëmirë Krasniqi, Nita Salihu Hoxha dhe Valdete Pacolli, me përfaqësues edhe nga MKRS - Fisnik Abazi dhe Arbenita Nuza - tash e një vit ka punuar pa ndalur për të krijuar një propozim të plotë se si duhet të duket Muzeu i ardhshëm i Artit Bashkëkohor të Kosovës.

Takime të përjavshme, vizita studimore, punëtori të gjata disaditore, konsultime të drejtpërdrejta dhe të organizuara me komunitetin artistik, siç ishte rasti me organizimin e simpoziumit vitin e kaluar, kanë rezultuar në një punë të palodhshme e shumë të çmuar, e cila me fillimin e konkretizimit të saj, do t'u shërbejë artistëve, qytetarëve, të rinjve e të rejave, turistëve të vendit dhe edukimit më të gjerë kulturor.

Ministri Çeku falënderoi anëtarët e ekipit që kanë dhënë kohën dhe përvojën e çmueshme për ta konceptuar këtë institucion që i mungon skenës kulturore në Kosovë.



# Shkarkohet Bordi i KPMM-së i emëruar nga pushteti

"Epoka e re"

PRISHTINË, 26 TETOR - Kuvendi i Kosovës ka shkarkuar të enjten Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Deputetët votuan fillimisht për shkarkimin e kryesueses së këtij Bordi, pastaj për anëtarët. "Konstatoj se Kuvendi ka shkarkuar kryesuesen Selvete Grajqevci-Pllana. 63 deputetë morën pjesë, 60 për, 3 abstenuan. Kuvendi shkarkon Gani Kastratin si anëtar të Bordit me 64 vota, 60 për, 3 abstenuan, asnjë kundër. Kuvendi e shkarkoi Gani Maliqin me 60 vota për dhe 4 abstenime. Kuvendi shkarkoi edhe Rrezarta Pushkolli-Makolli me 61 vota për, kundër asnjë dhe 3 abstenime", ka thënë kryeparlamentari Glauk Konjufca.

Në këtë votim nuk morën pjesë deputetët e tri partive opozitare PDK, LDK e AAK.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Armend Muja, tha se ka kanë konstatuar që në vazhdimësi janë licencuar kompani që nuk kanë kryer detyrimet ndaj KPMM-së dhe, po ashtu, janë proceduar penalisht për shkelje të ligjit. "Komisioni ka nxjerrë rekomandim që të shkarkohet anëtari i Bordit, Gani Maliqi, për arsye sepse është konstatuar se gjatë ushtrimit të detyrës ka pasur shkelje të neneve 59 dhe 60 dhe 62 të Ligjit për Komisione të Pavarura për Miniera dhe Minerale dhe qëllimisht apo nga pakujdesia ka shkelur dispozitat e nenit 60 të Ligjit për Komisione të Pavarura për Miniera dhe Minerale. Me datën 25.08.2021 Auditori i Brendshëm i KPMM-së ka konstatuar është shkelur udhëzimi administrativ 01 2011 për rregullat dhe procedurat e përllogaritjes së rendës minerale në rastin e kompanisë 'Ferronikeli'", ka thënë Muja.

Edhe për anëtarët e tjerë të këtij Bordi, Muja theksoi se rekomandohet shkarkimi meqë, siç tha ai, kanë shkelur Ligjin e KPMM-së. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Ferat Shala, ka thënë se minatorët tash e tri ditë janë në grevë për shkak të kushteve të rënda, ndërsa për këtë gjendje ka fajësuar Qeverinë e Kosovës për të cilën ka thënë se "i ka mashtruar keq". "Në Minierën e Trepçës po vazhdon sot dita e tretë e grevës. Minatorët në thellësi prej 700-800 metrash sot kanë kërkesa elementare sociale, ekonomike e menaxheriale. Kanë kërkesë që të kenë siguri në punë, t'i gëzojnë pagat e meritueshme, të ndryshojnë një menaxhment joligjor dhe jofunksional. Të gjitha kërkesat e minatorëve i mbështetim sepse janë legjitime. I bëj thirrje qeverisë të reflektojë sepse situatën e kemi në përkeqësim të skajshëm", është shprehur Shala para deputetëve.



Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se tendenca për të kapur gjithçka po e dëmton bazën kushtetuese dhe esencën e institucioneve dhe agjencive të pavarura që duhet të funksionojnë në Republikën e Kosovës. "Ndoshta këta është dashur të shkarkohen kur i ndanë 9 milionë euro për 'Ferronikelin', por para se të shkarkohen duhet të japin përgjigje se kush u tha t'i ndajnë këto mjete", ka thënë Zemaj.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se veprimin për shkarkim e sheh si hakmarrje të pushtetit. "Është po ky Bord që ka pasur një lëvdatë publike për këta persona që sot janë para Kuvendit për shkarkim. Pyetja për kolegët në LV është çka ka ndryshuar? Pushteti, kjo qeveri, ka ardhur me një premtim të madh që do të depolitizojë, dhe sot vjen me një kërkesë për shkarkim, me arsyen e vetme që nuk kanë arritur t'i përmbushin kërkesat tuaja. Dilni tregoni që nuk kanë qenë të përshtatshëm për qeverinë dhe jo t'i vëni etiketë", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se e sheh këtë veprim si hakmarrje. "Sot derisa ne po flasim është duke vazhduar një grevë e cila nuk ka asnjë trajtim serioz nga ministria përkatëse, qeveria dhe ne si Kuvend. Po flasim për një ndërmarrje që, ndoshta, është burimi kryesor për mbijetesë i asaj pjese", ka deklaruar Tahiri.

## Kuvendi miraton pesë projektligje, opozita nuk merr pjesë në votim

Kuvendi i Kosovës në seancën e së enjtes me shumicë të votave ka miratuar në lexim të dytë pesë projektligje. Për kanë votuar 64 deputetë të mazhorancës, ndërsa opozita nuk ka marrë pjesë në votim. Në lexim të dytë është miratuar Projektligji për Pronën Publike, ai për Prokurorinë Speciale, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ai për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale si dhe Projektligji për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës.

# Kryetari i Leposaviqit kërkon largimin e KFOR-it nga objekti i komunës, konsideron se situata është e qetë



PRISHTINË, 26 TETOR - Ka pesë muaj që kryetari i Leposaviqit, Lulzim Hetemi, jeton brenda ndërtesës së komunës. Thotë se do të vazhdojë të mbetet aty derisa largimin nuk ia kërkon shteti i Kosovës, përkatësisht qeveria dhe kryeministri Kurti.

Në një intervistë për RTK-në, Hetemi kërkon që KFOR-i të largohet nga objekti i komunës sepse konsideron se situata është e qetë.

Hetemi tha se kur hyri në komunë në muajin maj, përveç kaosit, nuk gjeti asnjë punëtor të administratës. Por tani, sipas tij, gjërat kanë ndryshuar.

Ka 13 drejtori, 7 drejtohen nga serbët e 6 nga shqiptarët. "Këta janë punëtorë të rinj të administratës. Janë serbë të Leposaviqit", tha Lulzim Hetemi.

E konfirmon se, përveç qeverisë dhe kryeministrit Kurti, të gjithë ia kanë kërkuar dorëheqjen. "Respekt për amerikan e respekt për miqtë tanë ndërkombëtarë", tha ai.

Hetemi ka folur edhe për mundësinë që të japë dorëheqje. "Dorëheqje… për çka", tha ai.

Kryetari i Leposaviqit tregon se është i gatshëm menjëherë të largohet nga zyra, me kushtin që në këtë pozitë të vijë një kryetar që njeh dhe respekton shtetin e Kosovës. E derisa të ndodhë kjo, Hetemi do të vazhdojë të qëndrojë brenda komunës së Leposaviqit.

## Dështon rezoluta e AAK-së për ngritjen e koeficientit të pagave, LV-ja e lëshon seancën

PRISHTINË, 26 TETOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka reaguar të enjten pasi mazhoranca e ka lëshuar seancën kur në rend ditë ishte rezoluta e propozuar nga ky grup parlamentar për koeficientin e pagave.

Tahiri ka thënë se shumica parlamentare sot ik nga seanca, nga përgjegjësia, nga detyrimet para qytetarëve, edhe nga debati. “Në vend se të lëvizet çdo gur për gjetjen e mënyrës për rritje të koeficientit, pra pagave, shumica parlamentare sot ik nga seanca, ik nga përgjegjësia, ik nga detyrimet para qytetarëve, ik edhe nga debati. Kjo qeveri, kjo shumicë, ua ka kthyer shpinën qytetarëve, shërbyesve civilë, pensionistëve, prindërve. Nuk do të ndalemi në kërkimin e llogaridhënies për këtë sabotim dhe papërgjegjësi. Qytetarët tanë duhet të jetojnë më mirë”, është shprehur Tahiri.

Ai ka theksuar se qytetarët tanë nuk ia kanë borxh askujt këtë sjellje politike e cila përhapjen e mjerimit dhe nënshtrimit e ka në epiqendër të veprimit politik. “Kjo është rezoluta e propozuar: 1. Kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në ndarjet buxhetore për vitin 2024, ta propozoj buxhetin e nevojshëm - ashtu që vlera e koeficientit të pagave nga 105 euro sa ishte në vitin 2023, për vitin e ri fiskal 2024 të ngritet në 129 euro dhe të bëhen përgatitjet e nevojshme që ky koeficient të hyjë në fuqi nga data 1 janar 2024”, ka theksuar Tahiri.



# Remitencat deri në muajin shtator tejkalojnë vlerën e 1 miliard eurove

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 26 tetor - Një miliard e 12.6 milionë euro është vlera e remitencave deri në muajin shtator, që paraqet rritje prej 11-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Kështu thuhet në statistikat e remitencave dhe institucioneve të tjera financiare për muajin shtator 2023, të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), duke shtuar se vlera e tyre, sipas vlerësimeve, ishte 116.9 milionë euro.

Sipas raportit, prurjet më të mëdha të remitencave ishin nga institucionet financiare jobankare me pjesëmarrje prej 57.4-përqindësh, pasuar nga kanalet e tjera me 24.4 për qind dhe bankat me 18.2 për qind.

BQK-ja tregon se 70 për qind e dërgesave të mërgatës vijnë nga vendet e Bashkimit Evropian, ku Gjermania ka pjesëmarrje me 38.1 për qind, ndjekur nga Zvicra me 17.6 për qind dhe ShBA-ja me 7.5 për qind.

Sa iu përket aseteve të kompanive të sigurimit, deri në muajin shtator vlera e tyre ishte 298.1 milionë euro, ndërsa asetet e fondeve pensionale kanë arritur vlerën e 2.62 miliardë eurove.




### Ndërmjetësit e tjerë financiarë

Asetet e ndërmjetësve të tjerë financiarë në fund të muajit shtator 2023 janë rritur për 3.1 milionë euro krahasuar me muajin paraprak duke arritur vlerën 479.0 milionë euro. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë të cilat përbejnë 70.9 për qind të gjithsej aseteve. Kreditë bruto të ndërmjetësve të tjerë financiarë në shtator 2023 shënuan vlerën për rreth 339.7 milionë euro, rritje kjo për 5.4 milionë euro krahasuar me periudhën paraprake. Kreditë ndaj ekonomive familjare në shtator 2023 përfaqësojnë 62.4 për qind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar.

### Kompanitë e sigurimeve

Asetet e kompanive të sigurimit në shtator 2023 kanë vlerën 298.1 milionë euro, e cila përfaqëson një rritje prej 2.2 milionë eurosh krahasuar me muajin paraprak. Struktura e aseteve në sektorin e sigurimeve përbëhet nga bilanci me bankat komerciale që përbëjnë 46.3 për qind letrat me vlerë dhe asetet e tjera përbëjnë 28.2 për qind të aseteve, ndërsa risigurimet përbëjnë 15 për qind të gjithsej aseteve.

### Fondet pensionale

Asetet e Fondeve Pensionale në fund të muajit shtator 2023 kanë arritur vlerën 2.62 miliardë euro, e cila përfaqëson një rritje prej 8.34 milionë euro krahasuar me muajin paraprak. Struktura e aseteve të sektorit pensional dominohet nga letrat me vlerë të kapitalit që përbëjnë 75.2 për qind të gjithsej aseteve. Vlera e tyre në shtator 2023 ka arritur në 1.97 miliardë euro, duke shënuar rënie për 13.3 milionë euro krahasuar me muajin paraprak.

## Serbia rrit buxhetin për institucionet paralele në Kosovë për 11 milionë euro

Prishtinë, 26 tetor- Më 26 tetor, deputetët e Kuvendit të Serbisë miratuan Ligjin për buxhetin e vitit 2024. Buxheti i Serbisë për vitin 2024 parashihet të jetë rreth 17.5 miliardë euro.

Nga ky buxhet, për vitin 2024 Qeveria e Serbisë ka planifikuar të ndajë rreth 11 milionë euro më shumë për Kosovën sesa që ishin ndarë më 2023.

Funksionimi i institucioneve dhe organizatave, Zyra e Qeverisë, informimi i serbëve në Kosovë, janë vetëm disa nga pikat, për të cilat do të rritet buxheti në vitin 2024.

Sipas një analize të Radios Evropa e Lirë (REL), ndarjet buxhetore për Kosovën janë vazhdimisht në rritje, dhe ekspertët paralajmërojnë se këto investime kanë qenë jotransparente me vite të tëra dhe se është pothuajse e pamundur të përcaktohet shpenzimi total për Kosovën.

Kosova e shpalli pavarësinë në vitin 2008, të cilën Serbia nuk e njeh. Serbia për gjithë ato vite nuk e ka ndalur financimin e institucioneve paralele, të cilat Prishtina nuk i njeh.

Serbia, siç shihet edhe në propozim-buxhet, ndan para për punën e institucioneve paralele në Kosovë, përmirësimin e jetës së qytetarëve, informimin, por edhe për mbështetje për klerikët dhe murgjit në Kosovë. Po ashtu, mbështet punën e Universitetit të Prishtinës me seli në Mitrovicën e Veriut dhe investon në projekte mjedisore.



# Mjeranët dhe llaskuçët e pushtetit!



Behxhet Sh. SHALA

**Një herë qyqan, gjithmonë qyqan:** “Nëse nuk e formojmë Asociacion Zajebnicën, në Kosovë do të ketë luftë dhe se 600 paramilitarë po ushtrojnë në Serbi për luftë në Kosovë...” ishte deklarata publike e një të mjeri të katapultuar në disa medie elektronike, si një zë i mekur i pushtetit në përpjekje për të krijuar një alibi për pajtimin e formimit të Zajebnicës nga KM i Kosovës, Albin Kurti. Po në të njëjtat valë ishte edhe numri dy i LV-së duke deklaruar se: “me një lexim sipërfaqësor të propozimit të Pesëshesh së Madhe, katërçipërisht dëshmohet se ky propozim është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës”. Tash mund ta merrni me mend se me çfarë deklarata do të dalin kur ta lexojnë dhe studiojnë këtë propozim thellësisht dhe përmbajtësisht. Sigurisht se do të propozojë që ky propozim të shpallet Kushtetutë e Kosovës për faktin se me vdekjen e kriminelit kushtetues, Mati Ahtisari, edhe Kushtetuta e Kosovës, që në vend të zemrës e ka Pakon e Ahtisarit, bëhet e pavlefshme. Tash mund të pritet që përkrahësit e Kurtit të dalin si Kori i Korbave për ta arsyetuar formimin e Asociacion Zajebnicës. Në këtë kontekst, një historian i Fadil Hoxhës nga periudha tititste e që bënë sfilata publicistike si alfa dhe omega i trurit, mendimit dhe veprimit patriotik të Bacës Adem Demaçi, haptazi thotë se Albin Kurti është shqiptari më i madh në 500 vjetët e fundit. Kështu sigurisht do të thoshte edhe për Bacën Adem po të ishte ai gjallë dhe po të ishte kryeministër i Kosovës. Këta që i vizatova në këta pak rreshta e që do të shoqërohen me një armatë injorantësh dhe përfituesish të posteve dhe atyre materiale e që Albin Kurtin e keqpërdorin sikur të ishte Fondi Sovran, në të kaluarën jo shumë të largët nuk kanë lënë mundësi apo pamundësi pa përdorur për t’i sulmuar mediatikisht, politikisht, kombëtarisht dhe njerëzisht, duke mos i përjashtuar as sulmet fizike, deri te granatahedhësit pikërisht ata që me sakrificën e tyre personale dhe familjare ua mundësuan të vinin në pushtet, derisa i dërguan në Hagë ku, si dëshmitarë “të mbrojtur”, angazhohen që të dënohen sa më shumë. Këta e sulmuan Isa Mustafën me armatim që përdorin terroristët duke ia rrezikuar jetën dhe familjen, ndërsa Kuvendin e Kosovës e shndërruan në poligon për gazin lotsjellës. Kinse për të penguar diçka që sot po e pranojnë duke ia shtuar bonuset si vetëmenaxhimi dhe shteti i kishës serbe në Kosovë. Pa njohje të pavarësisë së Kosovës, as faktike, as praktike, as juridike, as në qendër e as në thembër. Personalisht i kam besuar shumë Albin Kurtit, por jo edhe rrethit që e ka shoqëruar në “beteja” të gjata dhe të përgjakshme kundër Policisë së Kosovës, por jo edhe asaj ndërkombëtare, në beteja të pamoralshme kundër atyre që e çliruan vendin, e shpallën pavarësinë, e konsoliduan paqen dhe në linçime, pa asnjë kriter moral dhe njerëzor ndaj atyre që i përkrahën politikisht, kombëtarisht dhe materialisht”. Këta me mashtrime e shtruan rrugën për bashkim kombëtar për të na dërguar në stacionin e fundit drejt një federate a konfederate me Serbinë. Këta kanalizimin biologjik dhe politik të ish-udbashëve, titistëve, projugosllavëve dhe proserbëve i integruan në të gjitha postet më të rëndësishme institucionale në ndërkohë që pamëshirshëm ndjekin luftëtarët e UÇK-së, fëmijët e tyre, familjet e tyre duke i larguar nga puna ose duke bërë presion dhe terror psikologjik. Për presion fizik nuk ua mban bytha sepse janë qyqarë, i vendosin vezët sikur qyqja, në foletë e ngritura nga të tjerët. Çdo kohë dhe çdo proces i kërkon strukturat dhe personalitetet që i bien tamam kohës dhe proceseve. E kërkuan Bacën Adem Demaçi dhe ai qëndroi 30 vjet në burgje. E kërkoi Ibrahim Rugovën deri në Konferencën e Dejtonit pas së cilës i kaloi afati i përdorimit pasi në skenë doli e Lavdishmja Ushtri Çlirimtare e Kosovës me komandantët Adem Demaçi dhe Adem Jashari, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Ilaz Kodra, Sami Lushtaku dhe Sylejman Selimi, Remzi Ademaj dhe Rexhep Selimi, Ramush dhe Daut Hardinaj dhe shumë të tjerë që edhe e fituan përjetësinë duke u sakrifikuar edhe për lirinë e këtyre horrave dhe korbave që lirinë e kuptonin dhe e pranonin vetëm në kuadër të Jugosllavisë dhe Serbisë. E kërkuan Isa Mustafën dhe ai ishte aty. Pastaj Fatmir Sejdiu, Atifete Jahjaga dhe së fundi Vojsa Osmani. E kërkoi Albin Kurtin dhe ai i fitoi mbi 50 % të votave që asnjëherë nuk kishte ndodhur më parë e as që do të ndodhë ndonjëherë në Kosovë. Me një fjalë, me një përkrahje plebishitare, pa opozitë kundërshtuese dhe me asgjë penguese, me përkrahje ndërkombëtare sidomos gjermane dhe britanike, Albini kishte të gjitha mundësitë të jetësojë premtimet nga fushata zgjedhore, së paku një pjesë të tyre. Për fat të keq, deri më tani nuk ia doli përveç ta shndërrojë vendin në “lesh të Marisë”.

